



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:229210

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05503024

C.nr.80/18

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B... me seli në Prishtinë, rr. ..., kundër të paditurit G.LI nga Vushtrria, rruga ..., me objekt kontesti Rimbursim dëmi, me vlerë të kontestit 715.00 euro, në seancën përgatitore të mbajtur me datë 26.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET e tërhequr padia C.nr. 80/18 e datës 23.02.2018, e paditëses B... me seli në Prishtinë, rruga ..., kundër të paditurit G.LI nga Vushtrria, rruga ..., me objekt kontesti Rimbursim dëmi.

A r s y e t i m

Paditësja B... me seli në Prishtinë, rruga ..., në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurit G.LI nga Vushtrria, rruga ..., me bazë juridike-Rimbursim dëmi me vlerë të kontestit 715.00 euro.

Gjykata me datë 14.03.2024 ka mbajtur seancën përgatitore, në të cilën përfaqësuesi i paditëses dhe i padituri kanë kërkuar shtyrjen e seancës me qëllim të arritjes së marrëveshjes gjyqësore apo jashtëgjyqësore.

Në seancën përgatitore të mbajtur me datë 26.03.2024, nuk ka prezantuar paditësja dhe mungesën nuk e ka arsyetuar edhe përkundër thirrjes së rregullt me procesverbalin e datës

14.03.2024, po ashtu nuk ka prezantuar i padituri G.Ll, po ashtu i thirrur në mënyrë të rregullt me procesverbalin e datës 14.03.2024.

Marr parasysh faktin se në seancë nuk ka prezantuar paditësja dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, gjykata bazuar në nenin 409 par.1 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI**

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.80/18, me datë 26.03.2024

Gj y q t a r i

Jeton Zymeri

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.